

UDHËZIM PËR IDENTIFIKIMIN E DISKRIMINIT



**PARTNERITETI PËR TOLERANCË DHE
MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI NË SERBI**





UDHËZIM PËR IDENTIFIKIMIN E DISKRIMINIT

Beograd, 2012.



Autorët:

Prof. dr Nevena Petrušić, komisionerja për mbrotjen e barazisë
Kosana Beker, MA, ndihmës komisionerja për mbrotjen e barazisë

Botuesi:

Partnerët për ndryshime demokratike Sërbia
Qendra për zgjidhjen alternative të konflikteve

Për botuesin:

Blažo Nedić

Perkthimi:

Rajmonda Sylbije

Dizajni dhe faqosja:

Mlađan Petrović

Shtypi:

Manuarta, Belgrád

Tirazhi:

500

Publikimi „Udhëzimi për indentifikimin e diskriminimit“ është publikuar në kuadër të projektit „Partneritet për tolerancë dhe mbrojtje nga diskriminimi në Sërbi“ (Partnership for Tolerance and Anti-discrimination Protection in Serbia – PTAPS), të cilët bashkarisht zbatojnë Partneët për ndryshime demokratike në Sërbi (Partnerët Sërbia) dhe Qendra për zgjidhje alternative të konflikteve (CARS), në bashkëpunim me institucionin e Komisionit për mbrotjen e barazisë dhe me përkrahjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Sërbi. Qëllimi i projektit PTARS është të përmirësimi i sistemeve mbrojtëse nga diskriminimi në Sërbi dhe kontribuon në ndërtimin e kohezionit shoqëror. Qëndrimet e nxerura në praktikum paraqesin qëndrimet e autores dhe nuk paqyrojnë mendim të detyrueshëm.

Të gjitha termet në tekst janë të përdorura në gjininë mashkullore gramatikore, nënkuptojnë gjininë mashkullore dhe femrore të personave.

PËRMBAJTJA:

PARATHËNIE	5
FJALA E AUTORËVE	7
1. LEGJISLACIONET PËR MBROTJEN E DISKRIMINIMIT	9
2. C'FARË ËSHTË DISKRIMINIMI DHE SI T'A IDENTIFIKOJMË?	11
2.1. Cili është thelbi i diskriminimit?	12
2.2. Si mund të bëhet (ekzekutohet) diskriminimi?	13
2.3. A është diskriminim cdo bërje e dallimit?	13
2.4. Karakteristika personale si bazë e diskriminimit	14
2.4.1. C'farë është karakteristika personale?	14
2.4.2. Cilat tipare paraqesin bazën e diskriminimit?	15
2.4.3. Tipar i vërtet dhe i supozuar personal si bazë e diskriminimit	22
2.4.4. Tipari personal i dikujt mund të jetë bazë e diskriminimit	23
2.5. Kush mund të jetë diskriminues?	23
2.6. Kush mund të jetë viktimë e diskriminimit?	24
2.7. Në çfare marrëdhënie mund të vie deri tek diskriminimi?	25
2.8. Format e diskriminimit:	25
2.8.1. Diskriminimi i drejtëpërdrejtë (direkt)	25
2.8.2. Diskriminimi i tërthortë (indirekt)	26
2.8.3. Shkelja e parimeve të të drejtave të barabarta dhe detyrimeve	29
2.8.4. Thirja për përgjegjësi	30
2.8.5. Komploti për kryerjen e diskriminimit	31
2.8.6. Gjuha e urrejtes	32
2.8.7. Sjellje ngacmuese dhe nënqmuese	33
2.8.8. Format e rënda të diskriminimit	34
2.8.9. Rastet e veqanta të diskriminimit	35
2.8.10. Shkaqet e diskriminimit	35
2.9. Masat e posacme (afirmative)	37
3. RISHIKIMI I MEKANIZMAVE LIGJORE PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI	39

PARATHËNIE

„Praktikumi për mbrojtje nga diskriminimi“ është përpiluar në kuadër të projektit „Partneriteti për tolerancë dhe mbrojtje nga diskriminimi në Serbi“ (*Partnership for Tolerance and Anti-discrimination Protection in Serbia – PTAPS*), të cilin bashkërisht e implementojnë Partnerët për ndryshime demokratike në Serbi (Partnerët e Serbisë) dhe Qendra për zgjidhje alternative të konflikteve (CARS), në bashkëpunim me institucionin Komisioni për barazi dhe tw cilin e kan pwrkrahur Delegacioni të Unionit Evropian në Serbi dhe Sigrif Rausin Trust. Projekti PTAPS ka për qëllim përparimin e sisitemit të mbrojtjes nga diskriminimi në Serbi dhe Sigrid dhe kontribuimin në ndërtimin e kohezionit shoqëror nëpërmjet shtimit të informimit të qytetarëve rreth problemit të diskriminimit dhe mekanizmave ekzistues të mbrojtjes, ngritjes së kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile, ofruesve të ndihmës juridike dhe përfaqësuesve tjerë të grupeve të marginalizuara për të reaguar në mënyrë adekuate, si dhe për të krijuar kushte për aplikimin e ndërmjetësimit në rastet e diskriminimit.

Viteve të fundit është bërë progres i madh në përmirësimin e kornizës ligjore dhe institucionale të punës për luftë kundër diskriminimit në Serbi. Bazuar në ligjin kundër diskriminimit, të vitit 2009, është themeluar organi shtetëror autonom dhe i pavarur – Komisioni për barazi, kompetent për procedimin e rasteve të diskriminimit, dhe janë paraparë disa instrumente për mbrojtje të viktimave të diskriminimit. Megjithatë, përkundër kornizës së avancuar juridike dhe themelimit të institucionit të ri Komisionit për Barazi, hulumtime të numërta dhe praktika tregojnë se diskriminimi në Serbi është i pranishëm në masë të madhe, ndërsa mekanizmat ekzistues të mbrojtjes nuk shfrytëzohen sa duhet dhe në mënyrë adekuate.

Përpjekjet për të mbështetur një dialog të hapur në lidhje me diskriminimin në Serbi dhe për të rritur bashkëpunimin në parandalimin e diskriminimit, si dhe për të inkurajuar reagimin ndaj diskriminimit, kontribuojnë në respektimin e diversitetit dhe ngritjen e vetëdijes

publike për problemin e diskriminimit. Në kuadër të Projektit PTAPS janë organizuar një numër diskutimesh të panelit, uorkshope, trajnime, konferenca dhe aktivitete tjera: përpilimi i fletëpalosjeve, posterave, spoteve promovuese, filmave dhe materialeve tjera promovuese, si dhe përpilimi dhe distribuimi i „Praktikumit për mbrojtje nga diskriminimi“. Pjesë të veçantë të projektit paraqesin aktivitetet e ndërtimit të sistemit për zbatimin e ndërmjetësimit në rastet e diskriminimit, të cilat përfshijnë një numër seminaresh me qëllim të informimit të publikut për mundësitë dhe specifikat e zbatimit të ndërmjetësimit në këtë fushë, trajnimet e avancuara për përvetësimin e shkathtësive të domosdoshme për përfaqësim gjatë ndërmjetësimit, e gjithashtu planifikohet trajnimi i specializuar për ndërmjetësues për përfaqësim në rastet e diskriminimit.

Ashtu sikurse në bazë të Ligjit kundër diskriminimit është autorizuar Komisioni për Barazi për të rekomanduar ndërmjetësim në rastet e diskriminimit, në kuadër të projektit do të aplikohet edhe një model i veçantë për menaxhimin e procesit të ndërmjetësimit, që u është përshtatur resurseve ekzistuese dhe kompetencave të Komisionit për barazi.

Detaje më të shumta për projektin PTAPS mund t'i gjeni në adresën e internetit www.partners-serbia.org.

Blažo Nedić

Partnerët për ndryshime
demokratike në Serbi

FJALA E AUTORËVE

Te nderuar lexues dhe lexuese,

Para jush është nje publikim nga i cili mund të mësoni se c'farë është diskriminimi dhe cilat mjete gjyqësore mund te përdoren per mbrojtjen e diskriminimit. Shpresojmë që do t'i ndihmoi lexuesit në identifikimin dhe reagimin ndaj diskriminit dhe t'i inkurajoj t'i shqyrtojnë sjelljet dhe qëndrimet vetanake dhe që në mënyre aktive te kyqen në shuarjen e disriminimit të përhapur, i cili e asgjëson vetë idenë e të drejtave të njeriut dhe stagnon përparimin shoqëror. Në publikim janë dhënë informatat bazike lidhur me mekanizmat e mbrojtjes nga diskriminimi. Komisionerit per mbrojtjen e barazisë-trupit të pavarur, të specializuar për luftën kundër diskriminit, lidhur me akuzat per shkak të diskriminit, të cilat i drejtohen këtij organi, si dhe për mënyren e qasjes së tij sipas ankesave. Gjithastu, mund te mësoni se cilat janë mekanizmat tjerë që mund të përdoren për mbrojtjen nga diskriminimi.

Dëshirojmë të themi që diskriminimi nuk është një gjendje e cila duhej toleruar! Cdo rast i diskriminit i kryer me sukses është një kontribut i vlefshem në ndërtimin e shoqërisë në të cilën të gjithë qytetarët dhe qytetaret i kanë mundësitë e barabarta për zhvillimin e potencialeve të tyre dhe që në mënyrë të barabartë, aktive dhe produktive të marrin pjesë në të gjitha segmentet e jetës shoqërore, duke dhenë kontribut të plotë në zhvillimin e shoqërisë.

Autorët

1 LEGJISLACIONET PËR MBROTJEN E DISKRIMINIMIT

Sërbia u është kyqur shteteve të cilat i kushtojnë rëndësi të madhe shuarjes së diskriminimit dhe realizimit të barazisë, duke u përpjekur që me anë të ratifikimit të marrëveshjeve nderkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me miratimin e ligjeve të përshtatshme në sistemin vendas ligjor të integroi standardet më të mëdha nderkombëtare në këte fushë. Viteve të kaluara janë miratuar shumë rregullore për mbrotjen e diskriminimit dhe janë rregulluar mekanizmat për parandalimin dhe mbrotjen nga diskriminimi.

Diskriminimi është i ndaluar nga vetë *Kushtetuta e Republikës së Sërbisë (2006)*, si dhe nga ligje te shumta, me të cilat janë të percaktuara format dhe rastet e diskriminimit, si dhe mekanizmat mbrojtëse nga diskriminimi: *Ligji për ndalimin e diskriminimit (2002)*, *Ligji për parandalimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar (2006)*, *Ligji për barazinë gjinore (2009) etj.* Sipas vlerësimit të përgjithshëm, legjislacioni, me anë të cilit në Sërbi mbrohet liria nga diskriminimi, është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane dhe ofron nje kornizë të mirë ligjore për parandalimin dhe shuarjen e diskriminimit.

2 C'FARË ËSHTË DISKRIMINIMI DHE SI T'A IDENTIFIKOJMË?

Në kohën e fundit tek ne flitet dhe shkruhet shumë për diskriminimin, por kjo shprehje nuk përdoret shumë shpesh në domethënien e tij të vertetë, por përdoret për t'i shenjuar padrejtësitë e shumta, sjelljet e pahijshme dhe ofenduse si dhe lëndimet e shumë të drejtave të tjera . Për këtë arsye është me rëndësi të kuptohet thelbi i diskriminimit dhe kjo dukuri në mënyrë të kjashtë t'i demarkon nga sjelljet e ndaluara dhe të kundërligjshme.

Fjala „*diskriminim*“ do të thotë „*diferencim*“, kurse përdoret për etiketimin e diferencimit të ndaluar.

Duhet të dihet që diskriminimi nuk ka qenë gjithmonë i ndaluar. Përkundrazi, në periudha të caktuara historike të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, disa forma të diskriminimit kanë qenë të zakonshme dhe gjërësisht, të pranuar në shoqëri (psh. Skllavëria, sistemi i kastit në Indi, segregacioni i zezakëve në Amerikë dhe përafërt). Me zhvillimin e shoqërisë moderne, shumë forma të diskriminimit janë bërë të papranueshme dhe të ndaluara. Sot rregullat për mbrotjen e diskriminimit janë të përfshira në dokumentet e shumta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kurse shtetet kanë miratuar lidhje, me anë të të cilave qartë kanë ndaluar diskriminimin dhe kanë përshkruar mbrotjen nga disriminimi. Qëllimi i këtyre përshkrimeve është që cdo individ i t'i mundësohet qasje e barabartë dhe e drejte në shoqëri.

Ligji për ndalimin e diskriminimit është përshkruar ashtu që shprehjet „*diskriminimi*“ dhe „*trajtimi diskriminues*“ shënojnë cdo bërje të paarsyshme të dallimit ose të trajtimit, gjëgjësisht lëshimit (ckyqje, kufizim ose dhënie të gradimit), në raport me personin apo grupin, si dhe me anëtarët e tjerë të familjes apo personave të afërt, në mënyrë të hapur apo të mbyllur, por e cila bazohet në racën,

ngjyrën e lëkurës, paraardhësve, shtetësisë, përkatësisë kombëtare apo prejardhjes etnike, gjuhës, bindjeve politike dhe fetare, seksit, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjendjes së pasurisë, lindjes, tipareve gjenetike, gjendjes shëndetësore, invaliditetit, statusit martesorë dhe familjarë, dënimit, moshës, pamjes, anëtarësisë në organizatat politike sindikale si dhe në karakteristikat e ndryshme personale, reale të supozuara“

Ky definicion ligjor, si të gjitha definicionet tjera ligjore, është mjaftë i komplikuar, kështu që ne do të mundohemi t'a arsyetojmë dhe të japim një spjegim të thjeshtë të thelbit të diskriminimit.

2.1. CILI ËSHTË THELBI I DISKRIMINIMIT?

Thelbi i diskriminimit është qasje jo e barabartë ndaj të barabartëve dhe qasje e barabartë ndaj të jo barabartëve.

- Deri tek diskriminimi arrihet atëherë kur veprohet më keq (pafavorshëm) ndaj ndonjë personi apo grupit të personave, të cilët gjenden në situatë të ngjajshme me persona të tjerë, kjo për shkak të ndonjë karakteristike personale të dikujt.
 - Ne shpalljen për punë, të cilën me sukses mund t'a kryej cdo person, i cili është i aftë për punë, kërkohet personi deri në moshën 30 vjeqare, ku përjashtohen të gjithë personat të cilët janë mbi moshën 30 vjeqare.
- Deri tek diskriminimi arrihet edhe kur ndaj një personi apo ndonjë grupi veprohet njejtë si me të tjerët, edhe pse ata, për shkak të ndonjë karakteristike të tyre personale gjenden në pozitën e ndryshme në krahasim me të tjerët:
 - Është e paraparë që për regjistrimin e fëmijëve në shkollë duhet të paraqitet certifikata e lindjes nga libri i të lindurve; kjo rregullore është e njejtë për të gjithë, por në menyrë jo të barabartë i prek fëmijët romë sepse shumica e tyre nuk janë të regjistruar në librin amë të të lindurve.

Sic edhe mund të shihet, në rastin e parë diskriminimi pasqyrohet në atë që ndaj një personi apo grupit veprohet në mënyrë jo të barabartë për shkak të ndonjë karakteristike të tyre personale, përderisa në rastin e dytë, thelbi i diskriminimit është që ndaj një personi apo grupit të personave veprohet njejtë, por ky lloj i verpimit prodhon pasoja të

ndrsyhme (pafavorshme) në raport me atë person, gjegjësisht me atë grup, për shkak të ndonjë tipari të tyre, i cili nuk është marrë parasysh. Bashkarisht, edhe në diskriminimin e parë edhe të dytin, është rezultati perfundimtar – një person është në situatë të pafavorshme në krahasim me persona të tjerë, kurse burimi i asaj jo barazie është ndonjë tipar i tij personal.

Është e rëndësishme të dihet që një sjellje kualifikohet si diskriminuese, pa marrë parasysh nëse e kishte apo jo për qëllim këtë personi i cili e ka kryer diskriminimin.

2.2. SI MUND TË BËHET (EKZEKUTOHET) DISKRIMINIMI?

Diskriminimi mund të ekzekutohet në mënyra të ndrsyhme. Ndonjë personi, për shkak të ndonjë karakteristike personale, i mohohet ndonjë e drejtë, e cila për të tjerët është e vlefshme, apo kur ndonjë person vendoset në një situatë më të keqe duke i dhënë personave të tjerë përparësi, dmth ndonjë privilegj.

Diskriminimi kryesisht kryhet kur diskriminuesi bënë dicka (*psh. publikon shpalljen për punë, në të cilën cek që punëson vetëm serb*), por gjithashtu mund të kryhet edhe atëherë kur diskriminuesi nuk bënë atë që është detyrë e tij ligjore (*psh. institucioni shendetësor nuk i siguron qasje personave të cilët përdorin karroca*).

2.3. A ËSHTE DISKRIMINIM CDO BËRJE E DALLIMIT?

Duhet të dihet që jo cdo bërje e dallimit është automatikisht diskriminim. Në mënyrë që bërja e dallimit apo qasja jo e barabartë të karakterizohet sikur diskriminuese, bërja e dallimit, qasja jo e barabartë apo lëshimi, të jenë të *paarsyshme*. Kjo do të thotë që ka situata, në të cilat bërja e dallimit është e arsyeshme.

Ndonjëherë është e lehtë të konstatohet që bërja e dallimit ka qënë e arsyeshme (*psh. e arsueshme është që në qendrat për rekeacion të ekzistojnë zhveshtoret, të dedikuara për femra dhe për mashkuj*), por ndonjëherë kjo nuk është e lehtë, meqë ka raste kur është e nevojshme të bëhet një analizë e thellë për të hulumtuar nëse ky dallim ka qënë i nevojshëm.

Shembujt e dallimit të arsyeshëm:

- *Vendet e parkingut për automjetet e personave me invaliditet janë vecanërisht të shënuara dhe gjenden ne vendet më të afërta, me hyrjet në objekte të cilat janë në shërbim publik. Edhe pse kjo është bërje e dallimit (privilegjim i një grupi të njerzve), në këtë rast nuk është në pyetje diskriminimi sepse është plotësisht e arsyshme që personave, të cilët për ndonjë arsye më vëshitre lëvizin, t'i sigurohet casja më e lehtë dhe pa pengesa.*
- *Ndarja e klubeve sportive dhe garave sportive për meshkuj dhe femra gjithashtu mund të konsiderohet si bërje e arsyshme e dallimit, sepse meshkujt dhe femrat mjaftë dallojnë në ndërtimin e trupit dhe në fuqinë fizik, gjë e cila ndikon në diferencën e rezultateve të cilat i arrijnë.*

2.4. KARAKTERISTIKA PERSONALE SI BAZË E DISKRIMINIMIT

2.4.1. C'farë është karakteristika personale?

Që një trajtim jo i pabarabartë të jetë diskriminim, ai të bazohet në ndonjë karakteristikë personale. Me fjalë të tjera, nëse ndaj një personi veprohet jo barabartë, vetëm sepse ai është i ndonjë kombësie të caktuar, feje, gjinie, që ka ndonjë invaliditet dhe përfaqëson. Karakteristika e personave, në të cilën diskriminimi është bazuar quhet „bazë e diskriminimit“.

Ndonjëherë ndodhë që të veprohet jo barabartë ndaj ndonjë personi, por ajo sjellje nuk mund të karakterizohet sikur diskriminim sepse nuk është e bazuar në karakteristikën personale të atij personi, edhe nëse janë në pyetje sjelljet të cilat nuk janë të pranushme, jo të drejta dhe jo profesionale:

- *Shefi i një departamenti, në të cilin të gjithë të punësuarit vonohen me ekzekutimin e detyrave të punës, e dënon vetëm një të punësuar sepse nuk është sipmatik, përderisa punëtorët e tjerë verbalisht i paralajmëron;*
- *Zyrtari i administratës komunale pa rend e pranon një person të cilin e njeh, përderisa të tjerët presin në rend.*
- *Drejtori i ri i firmës maltreton dhe nënqmon punëtoreshen, e cila është bashkëshorte e drejtorit paraprak.*

2.4.2. Cilat tipare paraqesin bazën e diskriminimit?

Lista e tipareve personale, të cilat janë të cekura në Ligjin kundër diskriminimit, është mjaftë e plotë dhe e rëndësishme. Ajo nuk është e mbyllur, gjë e cila mundëson që me sjellje diskriminuese të karakterizohet dhe qasja jo e barabrtë e bazuar në karakteristikat e personave, e cila nuk është qartë e cekur në ligj.

Tipare personale të cilat me ligj janë qartë të shënuara

- **raca**
- **ngjyra e lekurës**
- **prejardhja**
- **nënshtetësia**
- **përkatësia kombëtare apo prejardhja etnike**
- **gjuha**
- **bindjet fetare apo politike**
- **seksi**
- **identiteti gjinor**
- **orientimi seksual**
- **gjendja e pasurisë**
- **lindja**
- **kataretistika gjenetike**
- **gjendja shëndetësore**
- **invaliditeti**
- **statusi martesor dhe familjar**
- **dënimet e mëparshme**
- **mosha**
- **dukja**
- **anëtarësimi në organizatat politike, sindikale dhe të tjera**

Shumica e tipareve personale nuk kërkojnë sqarime shtesë sepse rëndësia e tyre është vetë e kuartë. Megjithatë, disa karakteristika personale shkaktojnë shqetësime dhe për këtë arsye duhet t'i qartësojmë.

„Seksi“ nënkupton klasifikimin biologjik të njerëzve në qenie mashkullore dhe femrore; trupat mashkullor dhe femëror dallohen dhe kanë rrole të ndryshme në procesin e riprodhimit; ky dallim biologjik në mes të personave mashkullor dhe femëror ekziston në të gjitha kohërat dhe në të gjitha shoqëritë, pa marrë parasysh kushtet e jetës, statusin social, prejardhjen etnike apo racore; dallimet biologjike në mes të gjinive kryesisht janë univverzale, të dukshme dhe sipas rregullave, të pandryshueshme.

„Gjinia“ nënkupton rrollet shoqërore, sjelljet dhe përgjegjësitë të cilat janë të përshkurara për meshkujt dhe femrat në shoqëri caktuar; në atë se si shoqëria pret femrat dhe meshkujt të sillen dhe çfarë rrole imponon, ndikojnë shumë rrethana shoqërore, fetare, politike, ekonomike dhe rrethana të tjera sic janë zakonet, traditat, kuptimet morale dhe të tjera; qëndrimet dhe sjelljet, të cilat priten nga shoqëria ka nga gjinia mashkullore apo femërore janë të mësuara dhe ndryshojnë.

Dallimin në mes të „seksit“ dhe „gjinisë“ e ilustron shembulli në vijim: lindja e fëmijës është një rol biologjik i femrës, përderisa rroli i kujdesit për fëmijën e posalindur, i cili zakonisht i përshkruhet femrave, edhe pse edhe mashkulli në menyrë shumë të sukseshme mund të kujdeset për fëmijën.

Kohë të gjatë është konsideruar, disa edhe ende konsiderojnë që dallimet në pozitën shoqërore dhe në rrollet, të cilat meshkujt dhe femrat i kanë, imponojnë seksin e tyre dhe që ato janë të lindura. Kështu psh. disa konsiderojnë që ndarja e punëve në ato të meshkuve dhe ato të femrave është e natyrshme sepse femra i lind fëmijët dhe kështu, është e natyrshme që ajo dhe të kujdeset për ta, kurse mashkulli është fizikisht më i fortë, kështu që është e natyrshme që ai të jetë koka e familjës, që të përfitoi më shumë dhe të merr vendime. Megjithatë, është e qartë që nuk ka asgjë të natyrshme në këtë ndarje të punëve dhe që kjo nuk është rezultat i biologjisë, por është rezultat i rrethanave shoqërore.

„Orientimi seksual“ nënkupton një tërheqje të vazhdueshme emocionale dhe seksuale ndaj personave të seksit të caktuar. Sipas orientimit seksual, ekzistojnë personat të cilët i tërheq seksi i kundërt

(personat heteroseksual), personat te cilët i tërheq seksi i njejtë (personat homoseksual), si dhe personat të cilët i tërheqin të dy seksin (personat biseksual). Krahas këtyre, ekzistojnë edhe personat transseksual. Për të gjithë këta persona përdoret shkurtesa e pranuar ndërkombëtarisht LGBT. Në mes nesh jetojnë dhe personat transgjini, interseksual dhe aseksual, si dhe personat të cilët nuk pranojnë që ekzistojnë vetëm dy seks, gjegjësisht vetëm dy gjini. Për këtë arsye, kohët e fundit përdoret shkurtesa LGBTTIAQ.

Shembujt e diskriminimit në bazë të disa tipareve të personave individual:

– Raca/ngjyra e lekurës

- *Punëtorët e sigurimit të diskotekës nuk i lejojnë Romët të hyjnë në lokal, me arsyetimin që nevojitet një rezervim paraparak, përderisa vizitorëve të tjerë të lokalit nuk i kërkohet vërtetimi mbi rezervimin paraparak.*
- *Refuzimi i punëdhënësit që të punësoj një Rom.*

– Përkatësia kombëtare apo prejardhja etnike

- *Vozitësi i autobusit, me një ton të ngritur të zërit, urdhëron një grua Rome me femëun në dorë, e cila posedon biletën e rregulltë, që të kalojë nga ulësja e parë pas vozitësit në pjesën e fundit të autobusit.*
- *Dy të rinjë maltretojnë një person në autobus për shkak të theksit të tij, mendojnë që është Shqipëtar.*
- *Përderisa futbollisti nga Zimbabve ekzekuton penalltinë, tifozët e ekipit kundërshtar bërtasin: „Ua, majmun!“, „Ua zezak!“, kurse në tribunë është hapur një parull me simbolet Kju Kluks klanit.*

– Gjuha

- *Lejimi i emërtimeve të institucioneve, rrugëve dhe ndërmarrjeve në gjuhën e pakicave kombëtare, e cila është në përdorim zyrtar në teritorin e caktuar;*
- *Refuzimi i shitëses që t'a shërbej blerësin, i cili nuk e flet gjuhën e „saj“*

– Bindjet fetare apo politike

- *Punëdhënsi nuk i aprovon të pënsuarit, i cili nuk është i fesë ortodokse, t'a shfrytëzoi ditën e lirë në kohën e festës së tij fetare.*
- *Kundërshtimi i popullatës shumicë që në vendbanimin e tyre të ndërtohet xhamia apo sinagoga.*
- *Në klub boksi anëtarësohen vetëm meshkujt, të cilët kanë kartën e anëtarësimit të partisë nga e cila është kryetari i klubit.*
- *Një gruas të punësuar, të fesë muslimane, kryetari i sindikatës thotë që nuk mund të shkoj në ekskursionin sindikal sepse do t'i vijë qark manastirit ortodoks.*

– Gjinia

- *Punëdhënësi kërkon personat e gjinisë së caktuar për punët, të cilat në mënyrë të barabartë mund t'i kryejnë mirë edhe meshkujt, edhe femrat (psh. Kërkohet një femër atraktive për punë në butik).*
- *Punëdhënësi shkarkon një shtatëzënë.*
- *Punëdhënësi vendos në pozitat më të ulta dhe më pak të paguara femrat, të cilat kthehen pas pushimit të lindjes.*
- *Ne gazetat e përditshme është publikuar teksti në të cilin ceket: „Femrat e kanë vendin në shtëpi dhe nuk duhet lejuar që ato të merren me politikë“.*

– Identiteti gjinor

- *Mashkulli nuk e fiton punën e edukatorit sepse nuk është e zakonshme që meshkujt të merren me këtë punë.*
- *Shkolla refuzon të punësoj mësuesën, e cila ka flokë të shkurta, mban pantolla dhe luan futboll sepse ajo dukje dhe ajo veshje nuk është e zakonshme për femra .*
- *Shërbimi për punësim dërgon njoftim për konkurset për punë, inxhinierë të makinerisë vetëm meshkujve, jo femrave të cilat kanë përfunduar fakultetin e makinerisë.*
- *Profesori i fakultetit refuzon të pyes kandidatin, i cili ka ardhur i shminkuar dhe i cili mban stoli, me komente që është i veshur*

në mënyrë të pahijshme, të papërshatshme dhe që mund të vie në provim atëherë kur të jetë i veshur si mashkull, si edhe është dashur“.

- Të punësuarit përqeshin një kolegë, i cili ka bërë kërkesë për përdorimin e mungesës për t’u kujdesur për femiun.*

– Orientimi Seksual

- Shërbimi për transfuzionin e gjakut nuk i lejon personave të orientimit homoseksual të japin vullnetarisht gjak.*
- Në autobus, grupi i tifosëve keqtrajton fizikisht dhe psikikisht personin, i cili në reverin e palltos mban stemën e nyrave të ylberit me mbishkrimin „Të drejtat e LGBT-së“.*
- Gjatë mbajtjes së Paradës së krenarisë, grupi i huliganëve shkruan grafito nëpër fasadat e ndërtesave „Vrite pederin“ dhe „Ju presim“.*
- Një person u shquar një drejtim public ndaj pesmtarëve, pjesëmarrësit dhe pjesëmarrëset e Paradës së Krenarisë i quan „qelbësira sodome e cila ka helmuar dhe fliëqur gjithë“ qytetin.*

– Gjendja e pasurisë

- Trajtimi jo i barabartë i zyrtarëve në shallterë ndaj personave të varfur në krahasim me personat me gjendje më të mirë të pasurisë.*
- Rregullorja e ligjit, me anë të së cilës është përcaktuar se palën në gjykatë mund t’a përfaqësoi vetëm avokati, në situatën kur nuk ekziston një ndihmë e rregulluar ligjore pa pagesë për qytetarët e gjendjes së dobët të pasurisë, të cilët nuk kanë mundësi të paguajnë shërbimet e avokatit.*

– Nënshetësia

- Përcaktimi i emimit më të lartë të akomodimit në hotel për shtetasit e huaj.*

-
- *Refuzimi i investitorit që të shes banesën një shtetasi të huaj, me arsyetimin që mund të vinte deri tek britma nga ana e blerësve vendas, me këtë edhe deri tek vështirësimi i shitjes së banesave të tjera.*

– Lindja

- *Miratimi i rregullores, sipas të cilës e drejta për pranim të ndihmës financiare i pranohet vetëm personave të cilët janë të lindur ne territorin e komunës, e cila e ndanë këtë ndihmë financiare.*

– Paraardhësit

- *Drejtori i ndërmarrjes refuzon që të bëj kontratë me punëtorin, i cili ka arritur më së shumti rezultate në konkurs sepse babai i atij personi ka qenë drejtor paraprak i asaj ndërmarrjeje.*
- *Në gazeta është publikuar një tekst në të cilin, krahas të tjerave, ceket që fëmijët nga martesat e përziera janë problematikë dhe më pak inteligjent.*

– Karakteristikat gjenetike

- *Papërshatshmëri e plotë e makinave të punës dhe paisjeve për personat të cilët janë majtakë.*
- *Përqeshja e personave të cilët kanë albinizëm (mungesën e pigmenteve).*

– Gjendja shëndetësore

- *Institucioni shëndetësor shënon kartelat shëndetësore për personat të cilët jetojnë me HIV/AIDS.*
- *Klubi basketbollistik për junior i'a mohon një djaloshi të ushtri basketbollin sepse trajneri ka zbuluar që djaloshi vuan nga epilepsia.*
- *Ndarja e fëmijut, i cili jeton me HIV/AIDS, në klasa te vecanta në shollë.*

– Invaliditeti

- *Mospërshatshmëria e hapësirave publike dhe institucioneve shtetërore per personat të cilët përdorin karrocet per personat invalid, parku i qytetit i cili është i rrethuar me shkallë në vet hyrjen e parkut.*
- *Punëdhësi kërkon nga të punësuarit në arkë që në vendin e punës të qëndrojnë në këmbë gjatë tërë kohës, edhe pse kjo punë në mënyrë të kuartë mund t'i përshatet personave të cilët nuk mund të qëndrojnë në këmbë, duke i vendosur një ulëse.*

– Statusi martesor dhe familjar

- *Klubi ofron cmime përfituese vetëm cifteve të martuara, kurse partnerëve jashtëmartesor jo.*
- *Pronari i firmës refuzon të punësoi një grua të martuar në postin e sekretarëshës, me arsyetimin që për shkak të udhëtimeve të shpeshta, përparësi kanë gratë e pamartuara.*
- *Orari i punës i kopshtit të fëmijëve nuk është i përshtatur me orarin e zakonshëm të punës të prindërve (psh. mbyllet në orën 16h, kurse zakonisht orari i punës është deri në orën 17h).*
- *Ne kohën e darkës familjiare në restorant, gruas e cila ka filluar ta ushqej foshnjën me gjinjë, shefi i restorantit i thotë që të largohet nga restoranti dhe ta ushqej foshnjën në ndonjë hapësirë jashtë restorantit.*

– Dënimet

- *Mosmarrja e punës për shkak të ndonjë dënimi paraprak (psh. për ndonjë vepër nga fusha e trafikut, kurse personi konkuron për punë në shitore, butik)*
- *Refuzimi i qiradhënësit që të jap banesën një personi për të cilin din qe ka qenë në burg për shkak të ndonjë dënimit.*

– Moshë

- *Konkursi për punë, në të cilin është vendosur moshë e caktuar – psh. deri en moshen 35 vjeqare.*

-
- *Gjinekologu refuzon të bëjë kontrollën rutinore një gruaje, e cila është 70 vjeqare sepse, sipas mendimit të tij ka kaluar kufirin e moshës për kontrolla rutinore gjinekologjike.*
 - *Banka përshkruan që një hua, sipas gjirlllogarisë rrjedhëse, mund t'a realizojnë vetëm personat deri në moshën 65 vjeqare.*

– Dukja

- *Publikimi i shpalljes për punë, në të cilën kërkohen vetëm personat me dukje të mirë të jashtme.*
- *Mospunësimi i personave, të cilët kanë pirsing në fytyrë apo tatuazhe, me arsyetimin që ajo nuk do t'i pelqei klientëve, me të cilët ata do të jenë në kontakt.*
- *Refuzimi i ofrimit të ndihmës sociale për shkak të dukjes, me komentin „kur ke para të bësh tatuazhe, nuk të duhet ndihma sociale“.*

– Anëtarësimi në organizatat politike, sindikale dhe të tjera

- *Punëdhënësi refuzon që të avancoi të punësuarin, edhe pse ka arritur rezultate më të mira dhe i përmbush të gjitha kushtet për avancim, për shkak të angazhmanit të cekur në sindikatë.*
- *Personi nuk është pranuar në marrëdhënie pune, edhe pse në test ka treguar rezultate më të mira, për shkak se është aktivist i një partie me programin e së cilës drejtori nuk pajtohet.*
- *Drejtori largon nga puna një të punësuar sepse ka organizuar themelin e një organizate sindikale në ndërmarrje.*

2.4.3. Tipar i vërtet dhe i supozuar personal si bazë e diskriminimit.

Bazë e diskriminimit mund të jetë ndonjë tipar i vertetë, personal apo një tipar i supozuar personal. Tipar i vërtetë personal është ai tipar personal, i cili me të vërtetë ekziston, i cili është pjesë e identitetit të personit të caktuar (psh. personi i takon një populli, është i seksit të caktuar, moshës së caktuar dhe të ndryshme). Tipar i supozuar personal

është ai tipar personal, të cilin personi nuk e posedon, por diksriminuesi konsideron (beson) qe personi e posedon.

Shpesh herë ndodhë që personi, i cili ka miq të orientimit homoseksual mund të jetë edhe vetë i diskrimuar, sepse dikriminuesi supozon që edhe ai person është i orientimit homoseksual. Nesë mbiemri i nje personi mbaron me „iq“, ndonjë person mund të supozoi që ai person nuk është i kombësisë serbe dhe për këtë t'a diksirminoi.

Ndalohet diskriminimi në bazë të tiparit personal, pavarësisht se a ekziston me të vërtetë apo diskriminuesi vetëm supozon që ai tipar ekziston.

2.4.4. Tipari personal i dikujt mund të jetë bazë e diskriminimit

Tipari personal, në bazë të cilit një person është diskriminuar më së shpeshti ka të bëjë me vetë atë person (psh. *punëdhënësi refuzon të punësoj një shtatëzënë*). Ndonjëherë është, megjithatë personi i diksriminuar në bazë të karakteristikës personale, të anëtarit të familjes apo personit me të cilin ka raporte të afërta (psh. *nje vajzës me kombësi serbe i drejtohen fyerjet dhe kërcënimet sepse është në një marrëdhënie emocionale me një mashkull, i cili është i kombësisë rome; punëdhënësi shkarkon një grua sepse bashkëshorti i saj ka SIDËN*).

2.5. KUSH MUND TË JETË DISKRIMINUES?

Përgjigjja në këtë pyetje është mjaftë e thjeshtë – diskriminues mund të jetë gjithësecili. Diskriminimi është i ndaluar, gjithsecili është i obliguar të respektoi parimin e barazisë së njerëzve dhe askush nuk guxon të diskriminoi. Ndalimi i diskriminimit i referohet të gjitha organeve shtetërore, organeve te vetëqeverisjes lokale dhe te gjitha organeve të autoriteteve publike (*Asambleja Kombëtare, Qeveria e Republikës së Sërbisë, kryetari i shtetit, ministritë, gjykatat, agjensionet, kuvendet komunale, shtëpitë e shëndetit, mjekët, qendrat për punë sociale etj.*), cdo individ (të njohurit tanë, kolegët, zyrtarët e sporteve, shitësit, arkitektët, mjekët, arsmitarët, profesorët etj.), cdo personi juridik (*ndërmarrjet, asociacionet e qytetarëve, bankat, organizatat sportive*).

2.6. KUSH MUND TË JETË VIKTIMË E DISKRIMINIMIT?

Edhe në këtë pyetje përgjigjja është – gjithsecili. Viktimë e diskriminimit mund të jetë cdo individ, grup i personave apo person juridik.

Diskriminimi mund të ekzekutohet ndaj një individi (psh. *punëdhënësi refuzon të punësoi ndonjë personi i cili i takon dëshmitarëve të Jehovahit*). Duhet të ketë parasysh që mbrojtjen nga diskriminimi e gëzon jo vetëm shtetasi vendas, por edhe i huaji, i cili qëndron në teritorin e shtetit tonë.

Diskriminimit mund t'i ekspozohet një grup i personave, i cili ndërlidh *karactersikën e njejtë personale* (psh. *kur dikush publikisht thotë që femrat e kanë vendin në shtëpi, ai me këtë diskriminon të gjitha femrat; apo kur shtëpia e shëndetit nuk siguron qasjen e personave, të cilët përdorin karroca, ajo me këtë diskriminon të gjithë personat, të cilët përdorin karroca, kurse atyre i nevoiten shërbimet e shtëpisë së shëndetit*).

Viktimë e diskriminimit mund të jetë edhe *personi juridik*, në bazë të disa tipareve personale, të cilat kanë të bëjnë me statutin e vetë personit juridik (psh. vendi i regjistrimit, selia), karakteristikat personale të themelut, aksionarit, gjëgjësisht anëtarëve të personit juridik (përkatesia kombëtare, nënshtetësia dhe karakteristika të tjera), vetë qëllimet të cilat personi juridik pretendon t'i realizoi (psh, organizatë joqeveritare, e cila merret me promovimin e të drejtave të popullatës LGBT) dhe përafërt.

- Në procedurën e furnizimit publik firma është e ckytur sepse pronari i saj është Shqipëtar.
- Me aktet e përgjithshme të alencës sportive është e përshkruar, që me rastin e kalimit të lojtarëve në një klub të rangut më të lartë të klubit futbollistik të femrave, të paguhet një kompenzim më i ult për investimin dhe avancimin e lojtarëve në krahasim me kompenzimin, i cili i paguhet klubeve mashkullore të futbollit;
- Në konkursin për financimin e projektit është i refuzuar projekti i organizatës joqeveritare, e cila merret me personat e orinetimit homoseksual, edhe pse ishte më së miri i vlerësuar.
- Në gazeta është publikuar thirja për bojkotiminim e blerjes së prodhimeve ne objektet shitëse te një firme të huaj tregtare.

2.7. NË CFARE MARRËDHËNIE MUND TË VIE DERI TEK DISKRIMINIMI?

Diskriminimi mund të ekzekutohet në të gjitha fushat e jetës shoqërore, si në ato publike ashtu edhe në sferat private. Personi dhe grupi i personave mund të jenë të diskriminuar në fushën e arsimimit, punësimit, në fushën e marrëdhënieve të punës, në ofrimin e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, në trafik, në fushën e tregëtisë, ekonomisë dhe përafërt. Njerëzit pra, mund të jenë të diskriminuar në realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre, në sportel, kur blejnë biletën e autobusit apo kur i drejtohen ndonjë zyrtari në komunë, shkollë, fakultet, spital, sallë sportive, gjykatë, kur shkojnë në bankë të tërheqin kredi, kur lajmërohen në shpallje për punë dhe përafërt.

2.8. FORMAT E DISKRIMINIMIT:

2.8.1. Diskriminimi i drejtëpërdrejtë (direkt)

Diskriminimi i menjëhershëm (direkt) bazohet në idenë e barazisë së njerëzve. Në përputhje me këtë ide, duhet të sillemi barabartë ndaj personave, të cilët gjenden në situatën e njejtë apo të përafërt me të tjerët, pa marrë parasysh seksin, racën, kombësinë, fenë, bindjen politike, invaliditet apo ndonjë karakteristikë tjetër personale.

Diskriminimi i drejtëpërdrejtë ekziston nëse personi apo një grup i personave për shkak të karakteristikës së të diskriminuarit, gjëgjësisht në situatë të njejtë apo të përafërt, me cilin do akt, veprim apo lëshim, vendoset apo është i vendosur në një pozitë të pafavorshme, ose do të mund të jetë i vendosur në situatë të pafavorshme. Për këtë formë të diskriminimit është karakterisike baza e drejtëpërdrejtë (direkt) në tiparin personal. Me fjalë të tjera, tipari personal i personit është arsye (shkak) për veprim jo të barabartë ndaj tij:

- Qiradhënësi refuzon të jep banesën një Romi.
- Punëdhënësi i thotë të punësuarit që nuk do t'a dërgoi në trajnimin për punën në maikinë të re sepse është shumë i moshuar për t'i mësuar asftësitë e reja.
- Punëdhënësi fut një rregullore, sipas të cilës të punësuarit, të cilët janë të martuar, të kenë një rrogë 10 përqind më të lartë.
- Banka përshkruan një hua në llogarinë rrjedhëse (të ashuquajtur minusi i lejuar) të cilën mund t'a fitojnë klientët e

bankës nën moshën 65 vjeqare. Punëdhënësi publikisht shpallë mospunësimin e pjesëtarëve të pakicave kombëtare.

- Punëdhënësi publikisht thotë se nuk do të punsëoj pjestëar ë e pakicave kombtëare*
- Punëdhënësi në shpalljen për punë kërkon një person të seksit të caktuar, edhe pse në pyetje është një punë, të cilën mund t'a kryejnë edhe femrat edhe meshkujt (psh. kërkohet një artkatare për punë në market apo sekretarëshë)*
- Punëdhënësi përshkruan që pagesa për vajte në pension për meshkujt është 300 euro kurse për femrat 200 euro.*

2.8.2. Diskriminimi i tërthortë (indirekt)

Diskriminimi i tërthortë (indirekt) bazohet në idenë që ndaj personave, të cilët gjenden në pozita të ndryshme, duhet të qasemi ndryshe, të qasemi në atë masë e cila është e nevojshme për t'i siguruar qasje të barabartë të mirave shoqërore dhe mundësi të njejta për kënaqje të të drejtave dhe lirive. Përderisa diskriminimi i drejtëpërdrejtë ka të bëjë qasjen e ndryshme ndaj personave në situata të ngjajshme, diskriminimi i tërthortë ka të bëjë me qasjen e njejtë ndaj personave të cilët gjenden në situata të ndryshme. Me fjalë të tjera, diskriminimi i drejtëpërdrejtë ka të bëjë me qasje të ndryshme (pafavorshme), kurse tek diskriminimi i tërthortë nuk dallohen qasjet por dallohen pasojat, të cilat janë disproporcionalisht të pakëndshme në krahasim të një grupi të caktuar, gjegjësisht për individë të cilët i takojnë atij grupi.

Për dallim nga diskriminimi i drejtëpërdrejtë, ku në shikim të parë vërehet që është bërje e dallimit, gjëgjësisht ardhja në një situatë të pakëndshme në mënyrë direkte, e bazuar në tiparet personale, tek diskriminimi i tërthortë kjo nuk është e dukshme. Përkundrazi, duket gjoja që veprimi është bazuar në parimet e barazisë dhe jodiskriminimit, kurse kur shikohen pasojat, shihet që qasja e barabartë vendos personin apo një grup të personave në një pozitë të pafavorshme për shkak te tiparit të tyre personal në krahasim me personin apo grupin tjetër.

Diskriminimi i tërthortë *ekziston atëherë nëse personi apo një grup i personave, për shkak të tiparit të tyre personal vendosen në pozitë të pafavorshme me aktin, veprimtarinë apo lëshimin, i cili është gjoja i bazuar në parimet e barazisë dhe të ndalimit të diskriminimit, përveq nëse ajo është e arsyetuar më qëllimin ligjor dhe mjetet për këtë arritje të qëllimit janë të duhura dhe të nevojshme.*

Për të vërtetuar se pozita e pafavorshme është e lidhur me ndonjë tipar personal, shqyrtohet se mos gjoja ndonjë rregullore neutrale, joproportionale, pafavorshëm e godet një grup të personave me ato tipare personale në krahasim me të tjerët:

- *Në Shpalljen për punë, në të cilën si kusht është leja e vozitjes, edhe pse për kryerjen e asaj pune nuk është e domosdoshme leja e vozitjes – psh. kërkohet një punëtor administrativ ose shitës në market dhe përafërt.; me këtë kusht qysh në fillim janë të përjashtuar të gjithë ata që nuk posedojnë leje të vozitjes, pa marrë parasysh se a përmbushin kushtet tjera të konkursit – shumica e personave me invaliditet nuk do të mund të konkurojnë, sepse ende një numër i vogël i personave me invaliditet e kanë lejen e vozitjes në Sërbi, kjo për shkak të kushteve të papërshtatshme për të marrë pjesë në provimin e vozitjes dhe për shkak të shpenzimeve të mëdha në adaptimin e automjetit.*
- *Punëdhënësi kërkon që të gjithë kandidatët për punë të jenë të testuar në mënyrë që të vërtetohet gjendja e tyre fizike, fuqia dhe durimi, edhe pse në pyetje është një punë për kryerjen e së cilës nuk është vendimë marrëse fuqia fizike; me vendosjen e kësaj kërkesë mund të jenë të diskriminuar personat më të moshuar, nëse testi u është përshtatur vetëm atyre personave të cilët janë në kondicionin e plotë fizik.*
- *Drejtori i firmës ka vendosur që të bëjë vlerësimin e të punësuarve në fundvit, si kusht për avancimin e punëtorëve në pozita më të larta, dhe ka vendosur që të vlerësohen vetëm të punësuarit të cilën në vitin paraprak kanë punuar më gjatë se gjashtë muaj; me këtë, ai ka diskriminuar gratë të cilat gjatë vitit kanë shkftutëzuar pushimin e lindjes më gjatë se gjashtë muaj.*

Duhet të dihet që në disa raste të rregullave dhe kritereve, të cilat vlejné për të gjithë, nuk janë diskriminuese. Rast si ky do të jetë atëherë kur për futjen e tyre ekziston arsytimi objektiv dhe i arsytuar: kur ekziston qëllimi ligjor dhe kur mjetet, të cilat nuk janë të përdorura, nuk janë të domosdoshme dhe të duhura për arritjen e atij qëllimi. Pra, gjatë vërtetimit të ekzistencës së diskriminimit të tërthortë duhet të hulumtohen dy gjëra: 1) ne rastin konkret a ishte qëllimi i ligjshëm, apo 2) a janë mjetet e duhura dhe të domosdoshme për arritjen e atij

qëllimi. Nëse nuk kemi të bëjmë me këto gjëra, atëherë në pyetje është diskriminimi i tërthortë.

Në një shembull do të tregojmë se si vlerësohet ligjshmëria e qëllimit, domosdoshmëria dhe përshtatshmëria e mjeteve të cilat janë përdorur për realizimin e qëllimit:

Drejtori i firmës u ka ndaluar të punësuarve mbajtjen e çfarëdo lloj stolie. Ky vendim mund të paraqet diskriminimin e tërthortë të punësuarve, të cilët për shkak të arsyeve fetare dëshirojnë të mbajnë simbole fetare psh. Kryq, yllin e Davidit dhe për afërt. Megjithatë, mund të lejohet vendosja e kësaj ndalesë, që varet nga qëllimi, i cili me ndalesë është dashur të arrihet dhe nga vlerësimi se a ka qenë ndalesa e domosdoshme për realizim e qëllimit të dëshiruar. Nëse, psh. është në fjalë një firmë për prodhimin e hekurit, në të cilën të punësuarit punojnë në makina, ndalesa e mbajtjes së stolive do të ishte e arsyeshme sepse qëllimi është që të sigurohet siguria e punëtorëve në punë, prandaj vetë ndalimi është i domosdoshëm, është në proporcion me rrëzikun dhe është bazuar në rregulloret e sigurisë në punë. Megjithatë, nëse kemi të bëjmë me një agjension turistik, në të cilin të punësuarit kryejnë punë administrative, natyra e punës dhe vetë kushtet e punës bëjnë që ndalesa e bartjes së stolive nuk ka arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm.

Ndonjëherë ndodhë që qëllimi i vendosjes së ndonjë rregullore neutrale të jetë i ligjshëm dhe i arsyeshëm, por mjetet të cilat janë përdorur nuk janë të domosdoshme dhe të përshatshme për realizimin e qëllimit dhe për këtë rregullorja është diskriminuese:

Është përcaktuar rregullorja, sipas të cilës për regjistrimin e fëmijëve në shkollë nevojitet që prindërit të dorëzojnë dokumente të caktuara personale me të cilat vërtetohet identiteti i fëmijut. Qëllimi i kësaj rregullore është i ligjshëm dhe i arsyeshëm sepse me të sigurohet përcjellja e evidencës së fëmijëve, planifikimi i përdorimit të kuadreve financiare, të resurseve të shkollës etj. Megjithatë, dihet që shumë nga fëmijët rom nuk posedojnë dokumente personale dhe që zbatimi i kësaj rregulloreje mund t'i linte fëmijët rom jashtë sistemit arsimor. Për këtë arsye është e nevojshme të rishikohet se a mund të realizohet qëllimi i arsyeshëm (përcjellja e evidencës) me mjete të tjera më pak restriktive. Pasi këto mjete ekzistojnë (psh. dhënia e deklaratës verbale për lidhjen e fëmijut, me të dhënat e vitit, vendlindjes, prindërve dhe për afërt.), rregulla, sipas të cilës regjistrimi i fëmijëve është i kushtëzuar me dorëzimin e dokumenteve personale, paraqet diskriminimin e tërthortë të fëmijëve rom.

2.8.3. Shkelja e parimeve të të drejtave të barabarta dhe detyrimeve

Shkelja e parimeve të të drejtave të barabarta dhe detyrimeve është një formë e vecantë e diskriminimit, e cila bazohet në idënë që të gjithë njerëzve i takojnë të drejtat e barabarta dhe detyrimet sepse ligji është i njëjtë për të gjithë dhe të të gjithë janë të barabartë para ligjit, pa marrë parasysh tiparet personale.

Shkelja e parimit të të drejtave të barabarta dhe detyrimeve ekziston nëse një personi apo grupi të njerëzve, për shkak të tiparit të atij apo tipareve të tyre, në mënyrë të paarsyeshme i cënohen të drejtat dhe liritë apo i ipen detyrimet të cilat në situatën e njëjtë apo të ngjajshme nuk i cënohen personave të tjerë apo një grupit të personave, nëse qëllimi apo pasojat e masave të ndërmarra janë të paarsyeshme, si dhe nëse nuk ekziston një arsyeshmëri në mes të masave të ndërmarra dhe qëllimit i cili realizohet në këtë rast.

Thelbi i kësaj forme të diskriminimit nuk është zakonisht shumë i qartë, prandaj qytetarët shpesh mendojnë që cdo jobarazi paraqet shkeljen e parimit të barazisë.

Japim një shembull i cili e ilustron atë:

Me vendimin e vetëqeverisjes lokale është përshkruar që pas martesës, bashkëshortëve ti paguhet një ndihmë me vlerë nga 3000 euro, kurse si qëllim i marrjes së vendimit thuhet që është ngritja e shkallës së natalitetit në territorin e vetëqeverisjes lokale. Janë përshkruar dhe kushtet për marrjen e ndihmës njëherë, kështu që në mes tjerash kërkohet të jetë në pyetje martesë e parë e bashkëshortit, që njëri nga bashkëshortët të jetë i lindur në territorin e vetëqeverisjes lokale, që bashkëshortët para hyrjes në martesë nuk kanë fëmijë jashtë martesë si dhe që bashkëshortët s'kanë qenë në jetesën jashtëmartesore para hyrjes në martesë. Qëllimi i këtij vendimi është ngritja e natalitetit, i cili objektivisht është i arsyeshëm dhe vetëqeverisja lokale mund të përshkruan masat me të cilat arrihet lindja e fëmijëve. Megjithatë, analiza e kushteve ndër të cilat mund të fitohet ndihma financiare, tregon që e drejta për marrjen e asaj ndihme në mënyrë jo të arsyeshme u është mohuar disa qytetarëve dhe qytetareve, dhe atë: atyre që kanë krijuar jetesën jashtëmartesore, atyre të cilët s'kanë lindur në territorin e vetëqeverisjes lokale, atyre të cilët kanë fëmijë

jashtë martese, si dhe atyre të cilët para hyrjes në martesë kanë qenë veqse të martuar. Duke pasur parasysh që qëllimi i vendimit është ngritja e natalitetit, kushtet e vendosura nuk kanë aryetim objektiv dhe të arsyeshem. Fakti se a është dikush i martuar apo në një marrëdhënie jashtëmartesore, gjegjësisht, a i ka takuar më heret komunitetit jashtëmartesor, a ka fëmijë nga martesat e mëhershme apo ku është lindur – nuk janë relevante me qëllimin i cili është dëshiruar të arrihet, e ajo është ngritja e natalitetit.

2.8.4. Thirja për përgjegjësi

Në praktikë shpesh herë ndodhë që njerëzit, të cilët shprehin tendencën për të kërkuar mbrojtje nga diskriminimi apo e kërkojnë me të vërtetë, si dhe ata që shprehin gadishmërinë të dëshmojnë në favor të viktimës së diskriminimit, të jenë të ekspozuar ndaj pakënaqësive të ndryshme. Shpesh herë, mu për këtë, ndaj atyre sillet më keq se sa ndaj të tjerëve. Në mënyrë që njerëzit të jenë të inkurajuar të lajmërojnë dhe kërkojnë mbrojtje nga diskriminimi dhe të dëshmojnë rreth diskriminimit, ligji si një formë të vecantë të diskriminimit ka përshtetur të ashtuquajturën thirjen për përgjegjësi dhe në mënyrë të qartë e ka ndaluar.

Për këtë formë të diskriminimit shpesh përdoret shprehja viktimimizim. Kjo shprehje rrjedhë nga fjala „victim“ – viktimë, dhe përdoret për të përshtetur të gjitha ato të cilat bëhen ndaj dikujt në shënjë të shpëgimit të reagimit të tij ndaj diskriminimit.

Diskriminimi ekziston nëse *veprohet paarsyeshëm më keq ndaj një personi apo grupi të personave se sa veprohet apo duhej vepruar ndaj personave të tjerë, vetëm apo kryesisht për shkak të asaj që ata kanë kërkuar, gjegjësisht pretendojnë të kërkojnë mbrojtje nga diskriminimi, por për shkak se kanë ofruar apo pretendojnë të ofrojnë dëshmi për veprën diskriminuese.*

Kuptimi i kësaj rregullore është që të parandaloi personat të cilët kanë treguar për diskriminimin, gjegjësisht kërkuar mbrojtje ndaj diskriminimit, apo kanë dëshmuar, gjegjësisht planifikojnë të dëshmojnë në favor të viktimës së diskriminimit, durojnë pasoja negative. Me ndalimin e viktimizimit mbrohet viktimja e diskriminimit por edhe personat e tretë, të cilët i kanë ndihmuar viktimës së diskriminimit apo janë të gatshëm t'i ndihmojnë në realizimin e mbrojtjes ligjore nga diskriminimi:

-
- Një i ri, i cili jeton me HIV/AIDS ka inicuar procedurën për mbrotjen nga diskriminimi , sepse në punë është i ekspozuar ndaj ngacmimit. Punëtoret tjerë i shmangen kontaktit me të, shpesh herë i drejtojnë komente negative, jo rallë dhe ofendime. Edhe udhëheqësia sillet në mënyrë të përfaqshme me ata. Pas inicimit të procedurës për mbrotjen nga diskriminimi , drejtori e zhvendos në zyrë tjetër, në të cilën është vetëm.
 - Personit, i cili ka dëshmuar në procedurën gjyqësore të diskriminuesit, për shkak të gjuhës së urrejtjes ndaj popullatës LGBT, diskriminuesi dhe personat që ndajnë mendime të njejta me të, dërgojnë ofendime dhe kërcënime.

2.8.5. Komploti për kryerjen e diskriminimit

Komploti për kryerjen e diskriminimit paraqet një formë të posaçme të diskriminimit. Edhe pse liria e komplotit është një e drejtë e rëndësishme njerëzore, ajo liri nënshtron me kufizimet për të parandaluar keqpërdorimin e kësaj të drejte dhe pamundëson komplotin për realizimin e qëllimeve jo ligjore.

Është i ndaluar komploti për kryerjen e diskriminimit, gjëgjësisht veprimtaria e organizatave apo grupeve të cilat janë në drejtim të shkeljes së kushtetutës, rregullave të drejtave ndërkombëtare dhe ligjin e të drejtave dhe lirive të garantuara, apo për ngacmimin e urrejtjes kombëtare, racore, fetare dhe të tjera, për qarjes dhe jotolerancës.

Shembull për këtë formë të diskriminimit në Sërbë janë grupet e njerëzve të cilën kryejnë dhunë, zgjerojnë dhe shpërndajnë urrejtjen ndaj Romëve dhe pakicave të tjera kombëtare, pjesëtarët e popullatës LGBT, organizatave klerofasite... Nuk është ë domosdoshme që këto grupe të jenë të regjistruara, mjafton që individët të bashkohen dhe me veprimtarin e tyre të shkaktojnë urrejtjen racore, fetare apo urrejtje të tjera, grindje apo jotolerancë.

Gjykata kushtetuese mund të ndaloj regjistrimin e këtyre kompleteve, gjëgjësisht të ndaloj punën e tyre. Kështu, në qershor të vitit 2011, Gjykata Kushtetuese e Sërbisë i ndaloj organizatës „Nacionalni stroj“ të veprimtarisë, promovoi dhe zgjeroi qëllime dhe ide të programit të tyre, të urdhëroi organet shtetërore dhe organizatat, që në kuadër të detyrimeve të tyre të ndërmarin masa për qëllim të zbatimit të këtij vendimi, kurse në qershorin e vitit 2012 e ndaloj dhe lëvizjen „Obraz“.

2.8.6. Gjuha e urrejtjes

Gjuha e urrejtjes paraqet komunikimin publik të mesazhit të urrejtjes apo jotolerancës ndaj ndonjë grupi racor, kombëtar, fetar, etnik, seksual apo të ndonjë grupi tjetër të shoqërisë apo pjesëtarëve të saj. Më këtë nxitet, arsyetohet apo zmadhohet diskriminimi në bazë të racës, prejardhjes etnike, seksit, fesë, orientimit seksual apo ndonjë tipari tjetër personal.

Edhe pse liria e shprehjes është një e drejtë njerëzore mjaftë e rëndësishme dhe e garantuar për të gjithë, kjo e drejtë mund të jetë e kufizuar me ligj nëse është e domosdoshme për t'i mbrojtur të drejtat dhe reputacionin e të tjerëve, si dhe vlera tjera të rëndësishme shoqërore. Për shkak të pasojave të dëmshme dhe të rrezikshme, të cilat i nxit, gjuha e urrejtjes është e ndaluar, kurse disa forma më të rënda të gjuhës së urrejtjes paraqesin një akt të kimit.

Qartë, është e ndaluar shprehja e idesë, informacionit apo mendimit, me të cilin arrihet diskriminimi, urrejtja apo dhuna ndaj personave apo grupit të personave për shkak të tiparit të tyre personal në mediat publike dhe në publikime të ndryshme publike, në mbledhjet dhe në vendet publike, me shkrimin dhe emitimin e mesazheve apo simboleve, edhe në menyrë tjetër.

Gjuha e urrejtjes, si formë e diskriminimit, mund të shprehet në mënyra të ndryshme: me shkrimin e grafitëve dhe mesazheve nepër fasadat e ndërtesave „Magjupët, jashtë nga Serbia“, „Mbyte Shqiptarin“) apo publikim i mesazheve me mjetet e informimit, me anë të së cilës arrihet diskriminimi, urrejtja apo dhuna kundër personit apo grupit të personave, për shkak të përkatësisë apo jo përkatësisë së tyre racore, fetare, kombëtare, grupit etnik, seksit apo për shkak të orientimit të tyre seksual.

Gjuha e urrejtjes është një dukuri e rrezikshme shoqërore sepse mund të shkaktojë pasoja të paparashikueshme për grupin kundër së cilit është e drejtuar, nëse nuk reagohet në kohë dhe nëse njerëzit nuk dënohen për gjuhën e urrejtjes. Shembull nga historia e vonshme e luftës civile dhe gjenocidi në Ruanda, gjatë të cilit janë vrarë prej 500 000 – 800 000 njerëz, kryesisht pjesëtarë të popullit Tutsi. Propaganda mediale ka pasur një ndikim mjaftë të madh në ngjarjet në Ruanda, kurse gjuha e urrejtjes ka qenë e shpërndarë gjërësisht, e përkrahur dhe e pranuar. Shkallën e gjuhës së urrejtjes më së miri e ilustron fakti që shprehjet „Tutsi“ dhe „bubashvaba“ në media janë përdorur sikur sinonim.

Tek ne, gjuha e urrejtjes është mjaftë e shpeshtë ndaj pjesëtarëve të popullatës LGBT. Për shembull, një shoqatë ka dhënë deklaratë për rastin e Paradës së Krenarisë, në të cilën, në mes të tjerash, është e përmendur një fjalë „*për paradën e të devijuarëve seksualisht dhe për ata me të cilët hapet kutia e Pandorës, e cila nënkupton, një ditë dhe promovimin dhe pranimin e preferencave të tjera devijuese sic janë pedofilia, nekrofilia dhe përafërt.*“ Gjithashtu, të shpeshta janë rastet, në të cilat personat publik (politikanët, personalitetet kishtarë, ekspertët mjekësor) publikisht shprehin ide dhe qëndrime të përafërta. Gjuha e urrejtjes shpesh herë është e drejtuar edhe kundër popullatës rome.

Edhe pse shpesh personat, idetë dhe qëndrimet e të cilëve paraqesin gjuhën e urrejtjes, ftojnë në liri të fjalës, duhet të mirret parasysh që liria e shprehjes asnjëherë nuk guxon të jetë justifikim për gjuhën e urrejtjes.

2.8.7. Sjellje ngacmuese dhe nënqmuese

Diskriminimi shpesh herë bëhet ashtu që, ndaj personave apo grupit të personave sillet në mënyrë ofenduese dhe mënyrë nënqmuese, menyrë e cila cënon dinjitetin e tyre.

Është i ndaluar *ngacmimi dhe sjellja nënqmuese, e cila si për qëllim ka, apo paraqet lëndimin, e dinjitetit të personit apo të grupit të personave në bazë të tipareve të tyre personale, sidomos nëse me të krijohet frika dhe një mjedis jomiqësor, nënqmues apo ofendues.*

Sjellje shqetësuese dhe nënqmuese mund të kryhet në mënyra të ndrsyhme-verbalisht (psh. me shqipëtimin e fjalëve ofenduese), joverbalisht (psh. ndonjë gjest) apo me ndërmarrjen e ndonjë veprimtarie (psh. shkrimin e grafiteve). Që një sjellje të paraqes shqetësimin dhe nënqimin, nevojitet që kjo shprehje e jashtme negative ndaj një personit apo grupit të personave, të jetë e bazuar në ndonjë tipar të tyre personal, që ajo sjellje të ketë qëllim, apo që objektivisht të paraqes cënimin e dinjitetit të atij personi, gjëgjësisht atij grupi, veqanërisht nëse me atë sjellje krijohet nje mjedis i frikshëm, jomiqësor, nënqmues apo ofendues.

- *Aktori dhe regjisori i shquar, në deklaratën e tij në konferencën për shtyp, ka thënë që të gjithë dhuntinë e tij dhe kontributin e ka investuar në film, për t'i „porositur popullit të tij që ekziston dikush i cili don, respekton dhe vlerëson; që ekziton dikush i cili nuk e trajton si një cerg të Magjupëve, si bandën e vrasësve*

dhe si të cmendurit e Ballkanit pa një të ardhme“. Vendosja e gjithë popullatës rrome në lidhje me bandën e vrasësve dhe të cmendurit e Ballkanit, kontekstin negativ të gjithë deklaratës si dhe përdorimin e shprehjes fyese „Magjup“ paraqet cënimin e dinjitetit të pjesëtarëve apo pjesëtareve të pakicës kombëtare dhe krijon një mjedis nëncmues dhe ofendues.

- *Një person ka dëshiruar të blejë një këlysh, por shitësi, pasi ka kuptuar që blerësi ishte homoseksual, ka refuzuar t'ia shes këlyshin, duke thënë që homoseksualët seksualisht komunikojnë me kafshët.*

Rast i veçantë i ngacmimit paraqet ngacmimi seksual, viktimat e të cilit janë zakonisht gratë. Ngacmimi seksual mund të kryhet në mënyra të ndryshme, psh. me dërgimin e mesazheve epshore, komente seksiste, thirrjen për marrëdhënie seksuale dhe përafërt. Deri tek ngacmimi seksual, shpesh arrihet atëherë kur vitkima gjendet në një pozitë të nënshtuar ndaj atij personi, i cili e ngacmon seksualisht (psh. marrëdhënje e profesorit dhe studentes apo punëdhënësit dhe te punësuarës).

2.8.8. Format e rënda të diskriminimit

Disa aspekte dhe raste të diskriminimit janë veqanërisht të rrezikshme, vendi ku ekzekutohet dhe çfarë pasoja mund të shkaktoi. Zakonisht, këto lloje të rasteve ndahen dhe klasifikohen si forma të rënda të diskriminimit: 1) provokimi dhe nxitja e jobarazisë, urrejtjes dhe jotolerancës në bazë të përkatësisë kombëtare, racore apo fetare, gjuhës, orientimit politikë, seksit, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe invaliditet; 2) përhapja apo bërja e diskriminimit nga ana e organeve të autoriteteve publike dhe në procedurat para organeve të autoriteteve publike; 3) përhapja e diskriminimit me anë të mediave publike; 4) skllavëria, tregtia me njerëz, aperthejd, gjenocid, spatriimi etnik dhe përhapja e tyre; 5) diskriminimi i personit në bazë të dy apo më shumë tipareve të tij (diskriminimi i shumëfishtë apo i kryqëzuar); 6) diskriminimi i cili është kryer disa herë (diskriminim i përsëritur) apo i cili bëhet në një periudhë më të gjatë kohore (diskriminimi i zgjatur) ndaj personit të njejtë apo grupit të personave dhe 7) diskriminimi i cili qon deri tek pasoja të rënda për të diskriminuarin, persona të tjerë apo pasurinë, e posqërisht nëse kemi të bëjmë me një akt të dënueshëm, tek i cili shkak ekskluziv ka qenë urrejtja, gjëgjësisht jotoleranca ndaj të lënduarit, e cila është e bazuar në tiparin e tij personal.

Diskriminimi i shumëfishtë krijohet atëherë kur një person është i diskriminuar në bazë të më shumë tipareve personale. Për shembull, një grua invalide e kombësisë rome mund të jetë e diskriminuar në bazë të gjinisë së saj, përkatësisë kombëtare dhe invaliditetit. Diskriminimi i shumëfishtë është formë e rëndë e diskriminimit sepse pasojat negative janë shumë më të mëdha për viktimën.

2.8.9. Rastet e veqanta të diskriminimit

Me rregullore ligjore janë të rregulluara disa raste të veqanta të diskriminimit. Në pyetje janë rastet e diskriminimit, të cilat në praktikë më së shpeshti kryhen dhe prej një rrethi të gjërë të njerëzve. Disa nga këto raste kanë të bëjnë me diskriminimin në fushat e ndryshme (psh. në fushën e punës, ofrimit të shërbimeve), kurse disa janë të lidhura me tipare të personave të cilët u janë ekspozuara diskriminimit (psh. diskriminimi në bazë të seksit, në bazë të orientimit seksual). Rregulloret, me anë të cilave janë të rregulluara rastet e veqanta të diskriminimit, lehtësojnë uljen e diskriminimit sepse më afër rregullojnë se qfarë sjellje janë të ndaluara dhe mundësojnë që të identifikohet më lehtë diskriminimi. Me ligj janë të rregulluara rastet e diskriminimit në vijim: *në procedurat para autoriteteve publike; në fushën e punës; në ofrimin e shërbimeve publike dhe përdorimin e objekteve dhe sipërfaqeve: diskriminim fetar; në fushën e arsimit dhe aftësisimit profesional; në bazë të seksit; në bazë të orientimit seksual; diskriminimit të fëmijëve; diskriminimi në bazë të moshës; diskriminimi i pakicave kombëtare; diskriminimi për shkak të përkatësisë politike apo sindikale; diskriminimi i personave me invaliditet dhe diskriminimi në bazë të gjendjes shëndetësore.*

2.8.10. Shkaqet e diskriminimit

Shkaqet kyçe të diskriminimit janë paragjykimet dhe stereotipet e ndryshme, të cilat njerëzit i kanë për një grup të caktuar të njerëzve.

Paragjykimet janë lloje të qëndrimeve të caktuara rreth grupeve të caktuara shoqërore, të cilat nuk bazohen në njohje dhe vlerësim serioz, por paraqesin një mendim të pa bazë dhë të paargumentuar (psh. paragjykimmi që homoseksualiteti është sëmundje).

Paragjykimi nënvlerëson një grup të caktuar shoqëror, lehtë zgjërohet dhe ndikon në formimin e mendimit negativ dhe marrëdhënjes ndaj atij grupi. Paragjykimet më së shpeshti rrjedhin nga mosdija, edukimi, frika, konformiteti, dëshira që grupet e caktuara shoqërore të mbesin në pozitë inferiore dhe përafërt. Shumë mendojnë që paragjykimet nuk janë të rrëzikshme, por ato mund të na shpiejnë deri tek pasojat e paparashikueshme. T'a kujtojmë fatin e Cifutëve në Luftën e Dytë Botërore, ku i parapriu një qëndrim i përhapur që ata janë më pak të vlefshëm se sa të tjerët.

Stereotipet janë pasqyra të gabuara, shpesh herë dhe negative për një grup të caktuar shoqëror, ku vetitë e caktuara apo mënyra e sjelljes i përshkruan të gjithë pjesëtarët e atij grupi (psh. stereotipi që të gjithë Romët janë të papastër).

Me diskriminim janë të ndërlidhura shumë koncepte, sic është racizmi, seksizmi, homofobia, ejdzhizmi, ksenofobia dhe përafërt. Shumë nga konceptet janë të shënuara me shprehjet (termet), të cilat kanë prejardhje nga gjuhët e huaja, kurse kanë hyrë në gjuhën tonë të përditshme. Për shumë njerëz nuk është plotësisht e qartë se çfarë domethënie kanë këto terme, kështu që në pika të shkurta do të spjegojmë ato të cilat më së shpeshti përdoren, e të cilat janë të rëndësishme për kuptimin e shkaqeve të diskriminimit dhe për identifikimin e qëndrimeve dhe sjelljeve diskriminuese.

Racizmi është besim, sipas të cilit ekzistojnë dallimet e lindura dhe karrestike në mes të racave, përmes të cilit konsiderohet që një racë është më e rëndësishme dhe më e mirë se tjetra, do të thotë që është më superiore ndaj racave të tjera. Bërje e dalimit në mes të njerëzve ndaj racës së tyre quhet diskriminim racor.

Seksizmi është besim që njëri seks është më inferior, më pak i vlefshëm në krahasim me tjetrin, (psh. paragjykimi që femrat janë jo të afta të merren me politikë). Rjedh nga fjala angleze sex-seks). Ky term nënkupton dhe urrejtjen ndaj seksit të caktuar (mizigonia-urretja ndaj femrave dhe mizandria – urrejtja ndaj mashkujve). Nga seksizmi rrjedh diskriminimi në bazë të seksit.

Ejdzhizmi është qëndrim denigrues ndaj personave më të moshuar. Rjedh nga fjala angleze *age* – kohë). Nga ejdzhizmi rrjedh diskriminimi në bazë të moshës.

Homofobia është besimi që homoseksualët dhe biseksualët janë mëkatar, jomoral, të sëmurë, inferior në krahasim me heteroseksualët. Ky term përfshin edhe frikën dhe urretjen ndaj homoseksualëve.

Ksenofobia paraqet urretje dhe mosbesim ndaj të huajve. Ajo bazohet në paragjykimet etnike dhe fetare, racizmin, nacionalizmin dhe shovenizmin.

Për shuarje të suksesshme të diskriminimit duhej punuar sistematikisht në shmangjen e paragjykimeve dhe stereotipeve, në të cilën kanë një rrol shumë të rëndësishëm institucionet arsimore, mediat, organet e autoriteteve publike dhe organizatat joqeveritare. Prandaj, duhet të dihet që sjellja diskriminuese është pjesë e përditshmërisë tonë dhe që shumë forma të diskriminimit janë aq thellë të rrënjosura në vetëdijen e njerëzve, sa që shumica i konsiderojnë si të pranueshme. Për shkak të kësaj, për shuarjen e diskriminimit është e nevojshme, jo vetëm zbatimi strikt i ligjit dhe ndërmarrja e masave të caktuara ndaj atyre grupeve shoqërore, të cilat janë në pozitë jo të barabartë me qytetarët e tjerë, por që të zhvillohet edhe toleranca ndaj pakicave kombëtare, etnike, fetare, seksuale dhe të tjerave, si dhe respektimi dhe vlerësimi i dallimeve, të cilat ekzistojnë në mes të njerëzve.

2.9. MASAT E POSACME (AFIRMATIVE)

Masat e posacme (afirmative) janë masa të ndryshme ligjore dhe të tjera, të cilat ndërmerren me qëllim që grupet e caktuara shoqërore, të cilat faktikisht gjenden në pozitën e ultë, të arrijnë një barazi të vërtetë.) Përkatësisht, disa grupeve shoqërore të drejtat u janë shkurtuar me shekuj, sic është dhe rasti psh. me femrat, Romët, personave me invaliditet. Për këtë arsye, pozita e tyre në shoqëri është në gjendje të keqe, për këtë arsye janë në një pozitë jo të barabartë në pikëpamje të mundësisë për punësim, shkollim, përdorim, forma të ndryshme të mbrotjes sociale dhe përparimi deri tek pozitat ndikuese. Që këto padrejtësi historike të korrigjohen, duhet të ndërmerren masat, me të cilat largohen pasojat e diskriminimit të hershëm të grupeve shoqërore të caktuara. Me këto masa, grupeve shoqërore i ipet një përparësi për të ardhur në „pozicionin fillestar“, të njëjtë me atë të qytetarëve tjerë. Në këtë mënyrë, personat të cilët i takojnë atyre grupeve, vijnë në gjendje të barazisë dhe krijojnë kushte për krenarinë e të drejtave të njohura si të gjithë anëtarët e tjerë të shoqërisë.

-
- *Futja e rregullave në listat zgjedhore të partive politike për zgjedhje parlamentare, cdo i treti vend duhet të jetë i rezervuar për pjesëtarët e seksit më pak të përfaqësuar. Kjo është një mase e vecantë për arritjen e participimit politik të femrave, e cila duhet të ndikoi në rritjen e numrit të deputeteve kombëtare. Është futur për shkak të numrit shumë të ultë të femrave në Asamblenë Kombëtare të Sërbisë (22%), krahas faktit që femrat në Sërbi paraqesin 51,4 % të popullsisë. Në anën tjetër, përdorimi i shprehjes 'seksi më pak i punësuar' mundëson që kjo rregullore mund të zbatohet edhe në meshkuj – në rast se ndonjëherë në të ardhmen në parlament të jenë shumë më shumë femra.*
 - *Futja e rregullave, sipas të cilave cdo firm me më shume së 20 të punësuar, e cila punon më gjatë së dy vite, ka për obligim të punësoi numër të caktuar të personave me invaliditet, varësisht nga numri i përgjithsëm i të punësuarve; dhënia e subvencioneve punëdhënësve me hapjen e vendeve të reja të punës për punësim të personave me invaliditet dhe tek krijojnë kushte për qasjen e tyre te barabartë në tregun e punës, me anë të cilit kontribuon në përmirësimin e shoqërisë në përgjithësi.*
 - *Rregullimi, sipas të cilit studentët rom që të realizojnë të drejtën në burs edhe pse nuk i përmbushin të gjitha kushtet të cilat janë të parapara, me anë të cilit studentëve rom i mundësohet qasja më e lehtë në arsimim. Arsyeja e futjes së kësaj mase është fakt që pakica kombëtare rome ka pozitë shumë të ultë në Sërbi, që i takon grupit më të diskriminuar edhe atë në të gjitha sferat e jetës publike dhe private, si dhe që numri shumë i ultë i Romëve ka të përfunduar shkollimin e lartë në krahasim me popullatën shumicë.*

3 RISHIKIMI I MEKANIZMAVE LIGJORE PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Në mënyrë që të realizohet parimi i barazisë, nuk mjafton që vetëm shteti të proklamonte ndalimin e diskriminimit, por është e domosdoshme që të krijohet *sistemi efikas dhe i fuqishëm, ligjor nga diskriminimi*. Si dhe shtetet tjera, edhe shteti jonë ka krijuar mekanizma ligjorë të cilat mund të përdoren në rastet e diskriminimit. Ata mekanizma janë të radhës:

- Procedura para Komisionarit për mbrotjen e barazisë sipas ankesave për shkak të diskriminimit
- Proceset gjyqësore për mbrotjen nga diskriminimi
- E drejta penale për mbrotjen nga diskriminimi
- Mbrotja ligjore për kundërvajtje

Cdo mekanizëm ligjor i mbrotjes nga diskriminimi është i rregulluar me ligj dhe secili e ka qëllimin e posacëm. Disa përdoren për mbrotjen e vetë personit të diskriminuar, për të parandaluar përsëritjen e diskriminimit dhe për të larguar pasojat e diskriminimit, kurse disa përdoren për të dënuar diskriminuesin për atë që ka bërë. Në disa raste të diskriminimit duhet të përdoren më shumë mekanizma, sepse vetëm ashtu mund të parandohet manifestimi i diskriminimit.

Ligji parasheh KUR edhe NE cilat kushte secili nga mekanizmat ligjorë mund të përdoret dhe cila e drejtë ligjore të realizohet. Cilat mekanizma ligjorë mund të përdoren në rastin konkret të diskriminimit, varet nga shumë rrethana: Nga ajo se kush dhe si e ka kryer diskriminimin, cili tipar personal ka qenë bazë e diskriminimit, cilat janë pasojat e diskriminimit dhe përafërt. Për këtë arsye është e domosdoshme që në secilin rast të diskriminimit, në bazë të gjitha rrethanave, të sigurohet se me cilën rrugë duhet të fillohet, cilën veprimtari duhet ndërmarrë për të realizuar mbrotjen nga diskriminimi.

Nuk mund të parashihet paraprakisht se cilat mekanizma ligjor mund të përdoren për mbrotjen nga diskriminimi sepse ajo duhet vlerësuar vecantë për secilin rast.

Në fund, edhe njëherë dëshirojmë të themi: **DISKRIMINIMI NUK ËSHTË NJË GJENDJE E CILA DUHET TOLERUAR! DUHET TË REAGOHET DHE TË KËRKOHET MBROTJA!**

KOMISIONI PËR BARAZI

www.ravnopravnost.gov.rs

11000 Beograd, Beogradska br. 70

Tel: 011/243 64 64 e-mail: poverenik@ravnopravnost.gov.rs

Komisioni për barazi është organ i pavarur dhe i specializuar shtetëror i themeluar në bazë të ligjit mbi parandalimit të diskriminimit në vitin 2009. Detyra e Komisionit në fjalë është të luftojë të gjitha format e diskriminimit, ta ruajë barazinë, të mbikëqyrë zbatimin e rregulloreve antidiskriminuese dhe ta promovojë zhvillimin dhe mbrojtjen e barazisë.

Komisioni për barazi kryen procedurat rreth ankesave në rastet e diskriminimit, në të cilat vërteton nëse ka pasur ose jo diskriminim, jep rekomandime dhe vendosë masa të përcaktuara me ligj, e po ashtu mund të nisë një procedurë ligjore, me pëlqimin e personit të diskriminuar, dhe të paraqesë akuzë për kundërvajtje dhe penale. Po ashtu, parashtruesit të ankesës i ofron informacion për mënyrat e mbrojtjes nga diskriminimi, duke përfshirë mundësinë e zgjidhjes paqësore të situatës së krijuar.

Procedura nga ana e Komisionit nisët me **parashtrimin e ankesës**. Ankesën mund ta parashtrorjë secili person fizik ose ligjor ose grup personash, ashtu si edhe organizatat të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe personave tjerë.

Në ankesë duhet parashtruar të dhënat mbi personin e diskriminuar dhe mbi personin/organin i cili ka bërë diskriminim, të përshkruhet me çfarë akti, veprimi ose lëshimi është kryer diskriminimi, ku dhe kurrë ka ndohë, tiparet personale mbi bazën e të cilave është kryer diskriminimi dhe të ceken/paraqiten provat (dokumentet, dëshmitarët etj).

Ankesa duhet të jetë e nënshkruar. Komisioni nuk procedon ankesat anonime.

Procedura kryhet në atë mënyrë që Komisioni parashtronë ankesën për deklarim të palës kundër të cilës është parashtruar, grumbullon faktet dhe jep mendime nëse në rastin konkret është kryer diskriminimi.

Nëse vërtetohet se është kryer diskriminimi, atëherë palës diskriminuese i jepen udhëzimet për heqjen e shkeljes së ligjit, ndërsa në rastet kur pala në fjalë nuk vepron sipas udhëzimeve të dhëna, atëherë Komisioni i cakton palës masa paralajmëruese dhe cakton një afat të ri për heqjen e shkeljes së bërë mbi baza diskriminimi, izriçe mu meru opomene i ostavlja novi rok za otklanjanje povrede, dhe pas mbarimit të pasuksesshëm njoftohet publiku për diskriminin e kryer dhe sjelljen e palës diskriminuese.

Në shërbimin profesional të Komisionit është e organizuar puna e zyrës së pranimit, e cila qytetarëve u ofron këshilla juridike dhe informacion. Terminet për pranim mund të caktohen me anë të thirrjes në numrin e telefonit: 011/243 64 64.

Informata më të detajuara për kompetencat e Komisionit, mënyrës së parashtrimit dhe procedimit të ankesave mund t'i gjeni në faqen e internetit www.ravnopravnost.gov.rs

